


Analizë e përmbajtjeve me bazë gjinore:



**Dezinformatat  
gjinore pengesë për  
gratë në sport**

Analizë e përmbajtjeve me bazë gjinore:

# **Dezinformatat gjinore pengesë për gratë në sport**

**Botues:**

Instituti për Studime të Komunikimit  
rr. “Jurij Gagarin” 17-1 / 1, Shkup  
www.iks.edu.mk

**Rreth botuesit:**

prof. dr. ZanetaTrajkoska

**Edicioni:**

ResPublica

**Autore:**

mr. Bojana Jovanovska  
mr. Sara Milenkovska

**Redaktor:**

mr. Dejan Andonov

**Përkthyer nga gjuha maqedonase:**

Vjosa Taipi

**Titulli origjinal:**

Анализа на родово базирани содржини –  
Родовите дезинформации препрека за  
жените во спортот

**Dizajn grafik:**

Igor Dellov

**Vendi dhe viti:**

Shkup, 2024

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска  
библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

# Hyrje

Një nga arritjet më të rëndësishme të Olimpiadës Verore të këtij viti ishte fakti se barazia gjinore është arritur zyrtarisht përmes pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në lojërat sportive. Megjithatë, pavarësisht këtyre arritjeve, ende nuk ka barazi të plotë gjinore në botë. Sipas raportit për Hendekun Global Gjinor të Forumit Ekonomik Botëror, vlerësohet se do të duhen edhe 131 vjet për të arritur barazinë e plotë gjinore në të gjithë botën. Por normat kulturore dhe shoqërore ende udhëhiqen nga pritshmëritë stereotipike gjinore të grave dhe vajzave.

Për të ekspozuar efektet negative të stereotipeve gjinore dhe dezinformimit gjinor, është e nevojshme të krijohet një mjedis në të cilin informacioni analizohet në mënyrë kritike dhe media punon për të krijuar përgjegjësi sociale dhe kontribuojnë në avokimin e emancipimit të grave. Në këtë drejtim, ky hulumtim synon të eksplorojë përmbajtjen me bazë gjinore në media gjatë Lojërave Olimpikë Verore, duke iu referuar veçanërisht rastit të performancës së dy boksierëve - Imane Kelif dhe Lynn Youtin, e cila është thelbësore për të kuptuar se si ndërtohen narrativat për të minuar dhe marginalizuar atletet femra, veçanërisht ato që sfidojnë normat dhe pritjet tradicionale gjinore.

Dezinformatat jo vetëm që ndikojnë në perceptimin publik se si perceptohen atletet femra, por gjithashtu i vazhdojnë stereotipet e dëmshme,<sup>1</sup> duke kontribuar në krijimin e një mjedisi antagonist për atletet femra, transgjinore dhe jo-binare. Duke analizuar ndikimin e përhapjes së informacionit të rremë dhe narrativëve të njëanshme për boksieret, ky hulumtim hap temën e dezinformatave gjinore në sport dhe implikimet më të gjera të tyre. Qëllimi është gjithashtu të adresojë paraqitjen e drejtë dhe të saktë të këtij lloji të lajmeve në media me shpresën e avancimit të përpjekjeve për të nxitur përfshirjen dhe respektin në komunitetin sportiv për gratë. Duke përdorur rastin e boksieres algjeriane Kelif, mund të njihet krijimi i qëllimshëm i narrativave të dezinformatave, të cilat, në fakt, bazohen në narrativa dhe vlera tashmë të njohura antigjinore dhe transfobisë. Përkundër faktit që Kelif ka njoftuar në mënyrë të përsëritur se ajo ka lindur grua

1 [TROLL OF THE MONTH: Media coverage of Imane Khelif - Reporting Diversity Network](#)

dhe identifikohet si grua, veçanërisht duke marrë parasysh origjinën e saj nga Algjeria ku është e pamundur të bëhet një ndryshim i gjinisë, kjo nuk ishte e mjaftueshme që ky rast të keqpërdorej nga publiku për qëllime anti-gjinore.<sup>2</sup>

Narrativa që ishte dominues në media në Maqedoninë e Veriut portretizoi boksieret Imane Kelif dhe Lin You-tin si burra ose njerëz transgjinorë që konkurronin në kategorinë e grave, duke provokuar kështu drejtpërdrejt gjuhën e urrejtjes në media dhe në rrjetet sociale. Për më tepër, Kelifi u sulmua për pamjen dhe racën e saj që shkojnë përtej standardeve perëndimore të bukurisë. Në të njëjtën kohë, disa përfaqësues të kishës i ndanë këto dezinformata në profilet e tyre në Facebook, duke nxitur një ndjenjë të vendosur anti-LGBTIQ+. Lëvizjet anti-gjinore në vend kanë kohë që përhapin në mënyrë aktive dezinformata dhe përdorin çdo ngjarje për të amplifikuar këto narrativa. Narrativa të cilat Kisha Ortodokse e Maqedonisë dhe Koalicioni për Mbrojtjen e Fëmijëve shpesh i mbështesin.

Kjo analizë, e titulluar “Dezinformatat gjinore pengesë për gratë në sport”, është analiza e pestë e përmbajtjeve me bazë gjinore e përgatitur nga Instituti për Studime të Komunikimit në kuadër të projektit “Përdorimi i gazetarisë së bazuar në fakte për rritjen e ndërgjegjësimit dhe për kundërshtimin e dezinformatave në hapësirën mediatike në Maqedoninë e Veriut”, i cili zbatohet me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup.

2 [Boksierja algjeriane Imane Kelif, nuk është mashkull biologjik | Meta.mk](#)

# Konteksti i analizës

Vetë analiza, përveç njohjes së mekanizmave të ndryshëm mbi të cilët kryhet disiplina e trupit femëror në publik dhe diskriminimi, do të ndihmojë gjithashtu në identifikimin e rasteve të ardhshme të mundshme të marrëdhënieve të grave në sport, pasi rasti i Imane Calif dhe transmetimi i dezinformatave në lidhje me Lojërat Olimpikë Verore nuk janë unike. Nëse merret parasysh konteksti më i gjerë, do të shihet se standardet e dyfishta për gratë në sport në të kaluarën kanë qenë normë, jo përjashtim. Që nga ditët e para të hulumtimit të mediave sportive, hulumtimi ka treguar vazhdimisht se atletet femra marrin vëmendje mediatike minimale, shpesh duke u marginalizuar ose përjashtuar, veçanërisht në raportimin ditor (Toffoletti, 2016), madje edhe gjatë ngjarjeve të profilit të lartë siç janë Lojërat Olimpikë (Delorme dhe Testard, 2015; Salido-Fernandez, 2020). Kjo pabarazi buron nga natyra e mbizotëruar nga meshkujt e mediave sportive, e cila i jep përparësi sportive të meshkujve për shikueshmërinë kryesisht të meshkujve. Jo vetëm që gratë janë të nën-përfaqësuara (Billings et al., 2010; Jones, 2013), por ato duhet të arrijnë rezultate të jashtëzakonshme në mënyrë që sukseset e tyre të pranohen në përgjithësi. Edhe kur ka mbulim mediatik, gratë shpesh portretizohen në një mënyrë trivializuese, të njëanshme ose stereotipike, duke u fokusuar në emocionet, pamjen ose rolet e tyre familjare (Eagleman, 2015; Ravel & Garo, 2016).<sup>3</sup> Vetë mënyra e raportimit tashmë kontribuon në të ashtuquajturën përkatësi e grave në sport. Çështja nëse dhe cilat gra i përkasin sportit nuk është aq diskriminuese përmes narrativave për gratë në sport, si dhe paraqitjes së atleteve femra dhe sukseseve dhe dështimeve të tyre.

Në të kaluarën, nuk ishin vetëm mediat që i stereotipizuan gratë, por vetë diskriminimi gjinor u institucionalizua. Për shembull, organet drejtuese ndërkombëtare të sportit, të tilla si Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (KON) dhe organi drejtues ndërkombëtar për futbollin (FIFA), kanë kërkuar të promovojnë sportin e grave dhe pjesëmarrjen e grave në sport. Megjithatë, këto përpjekje nuk tregojnë se këto organizata kanë pushuar së qeni institucione të hegjemonisë

3 [Salido-Fernandez, J. & Muñoz-Muñoz, A.M. \(2021\). Përfaqësimi mediatik i sportistëve femra në Lojërat Olimpikë: një rishikim sistematik. Apunts Educación Física y Deportes, 146,32-41.](#)

patriarkale (Fink, 2008; Williams, 2014). Iniciativat për të promovuar sportin e grave thjesht mund të pasqyrojnë kërkimin për klientë të rinj në një treg gjithnjë e më të ngopur për argëtimin sportiv. Megjithatë, ka dëshmi se përpjekje të tilla promovuese kanë frymëzuar më shumë pjesëmarrje në elitën sportive të grave (për shembull, Jacobs, 2014).<sup>4</sup> Misioni<sup>5</sup> i Lojërave Olimpikë përshkruan parimet e mëposhtme:

” të inkurajohet dhe të mbështet promovimi i grave në sport në të gjitha nivelet dhe në të gjitha strukturat me qëllim zbatimin e parimit të barazisë së burrave dhe grave”.

Por edhe më të rëndësishme në këtë situatë ishin këto parime për të cilat është thelbësore të vazhdohet të punohet:

” të veprojë kundër çdo forme diskriminimi që ndikon mbi Lëvizjen Olimpikë;

” të promovojë sport të sigurt dhe të mbrojë atletët nga të gjitha format e ngacmimit dhe keqpërdorimit.”

Kjo është arsyeja pse konteksti dhe sulmi ndaj atleteve femra është gjithashtu i rëndësishëm, ky sulm ndaj feminitetit nuk është vetëm një sulm ndaj pamjes, por edhe ndaj vetë përfshirjes dhe motivimit të përfshihen gratë në sport. Në vitin 2024 ka një nivel të rritur të narrativave anti gjinore në hapësirën publike, por është e rëndësishme të kuptohet se kjo praktikë e dezinformimit gjinor dhe stereotipizimit gjinor ka vazhdimësi. Disiplinimi i trupit dhe pamjes femërore në sport, veçanërisht është një praktikë që lidhet me sukseset që gratë kanë në sport. Tenistja Serena Williams u fye në mënyrë të përsëritur në media dhe është vënë në dyshim gjinia e saj<sup>6</sup> - ndërsa komentet u përqendruan në muskujt dhe performancën e saj. Por këtu, veçanërisht nëse ndërlidhet rasti i Imanit dhe atleteve të tjera, elementi racor nuk duhet të lihet anash.

4 [Women in International Elite Athletics: Gender \(in\)equality and National Participation](#)

5 <https://olympics.com/ioc/mission>

6 <https://www.businessinsider.com/serena-williams-responds-to-accusations-she-was-born-a-man-2018-5>

Në fakt, sipas analizës së Grover, shpesh ndërthuret në vijën midis gjinisë dhe seksit kur racizmi, mizogjia dhe transfobia përcaktojnë nocionet e feminitetit në botën e sporteve elitare<sup>7</sup>.

Në këtë drejtim, 15 vjet më parë - situata me Caster Semenya është një shembull i fuqishëm se si media mund të riprodhojë dezinformimin gjinor dhe të inkurajojë debate publike bazuar në pikëpamje diskriminuese. Në vend që të festonte suksesin e saj të jashtëzakonshëm si atlete, gjinia dhe identiteti i saj u bënë një pikë qendrore e raportimit mediatik. Një raportim i tillë jo vetëm që shkel privatësinë e atletëve, por edhe normalizon skepticizmin publik dhe diskriminimin ndaj grave që nuk përshtaten me normat tradicionale të feminitetit. Por gjithashtu siç thekson Grover, gratë me ngjyra të tjera të lëkurës, veçanërisht gratë e zeza, shpesh maskilizohen dhe defeminizohen nga Veriu Global, duke çuar në një paragjykim të paqartë që kontribuon në diskriminim në bazë të pamjes së tyre. Ndikimi i heterocentrizmit dhe etnocentrizmit përcakton prototipin e gruas si heteroseksuale dhe të bardhë. Sipas kësaj qasjeje, për mediat, duart e mëdha, shpatullat e gjera dhe nofulla e fortë e Semenya-s, e dallojnë atë nga standardet tradicionale të bukurisë në Evropën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut, duke e bërë atë më të prekshme nga kontrolli i Shoqatës. Por standardet e bukurisë të vendosura në këtë mënyrë, por edhe trajtimi i atleteve femra, i bëjnë ato më të ndjeshme ndaj të qenit viktimë të dezinformimit gjinor dhe dhunës digjitale. Pastaj, rasti i gjimnastes<sup>8</sup> olimpike Simone Biles, suktesi i së cilës kushtëzohet nga «atletizmi i çuditshëm», përsëri tregon se narrativat për gratë e zeza janë plot diskriminim dhe stereotipizim që ka një histori koloniale dhe raciste. Për shembull, përshkrimet raciste që poshtërojnë trupat e grave të zeza dhe pjesët e trupit, duke përfshirë hundët e sheshta, prapanicat e mëdha ose që përshkruhen përmes karakteristikave të kafshëve, kanë një histori dhe praktikë koloniale. Që kjo të jetë e mundur - duhet parë rrënja, ndoshta rasti më vendimtar dhe i dokumentuar mirë që ka ndikuar në kulturën se si trajtohen trupat e grave, veçanërisht të grave me ngjyrë, është Sarah Baartman. Sarah Baartman (e njohur edhe si Saartje, Saarji ose Sara) ishte një grua e Afrikës së Jugut e cila u soll me dhunë dhe më pas u përfaqësua në të gjithë kopshtet zoologjike njerëzore dhe cirqet në Angli dhe Francë në fillim të shekullit të 19-të, mbi trupin e së cilës u

7 [Straddling the line between gender and sex: How racism, misogyny, and transphobia intertwine to define notions of womanhood in the world of elite sports](#)

8 <https://www.newyorker.com/magazine/2016/05/30/simone-biles-is-the-best-gymnast-in-the-world>



krijuan shumë stereotipe fiktive raciste dhe të seksualizuara të grave të zeza. Stereotipet e sotme ekzistojnë në kontekst, dezinformimi i sotëm ekziston tashmë duke vendosur standarde për bukurinë, feminitetin dhe pritshmëritë gjinore.

Është e rëndësishme të theksohet se dëmtimet e vazhdueshme fizike në trupat e tyre gjatë garave dhe trajnimeve që psikologët sportivë<sup>9</sup> konfirmojnë se janë kërcënuese për karrierën mund të ekspozojnë vetëvlerësimin më të thellë të atleteve femra. Shërimi nuk është vetëm një çështje e fuqisë shëruese të trupit biologjik, madje edhe ndër atletet më të fuqishme mund të humbasin ndjenjën e vetëvlerësimit dhe vetë-pranimin që janë pjesë e qëndrueshmërisë dhe suksesit të tyre. Prandaj, ndikimi mediatik i vetë-perceptimit dhe vlerësimit të tyre mund të ndryshojë plotësisht imazhin, por edhe rrugën e tyre të jetës përmes dhunës së vazhdueshme digjitale.

9 [What the dominance of black female athletes means to American culture - ESPN](#)

# Metodologjia

Qëllimi i kësaj analize ishte identifikimi dhe analizimi i përmbajtjes me bazë gjinore që bazohej në transfobinë dhe dezinformatat gjinore në mbulimin mediatik të Lojërave Olimpikë, siç është rasti i Imane Kelif, si dhe diskutimet që provokoi në mediat sociale. Ky hulumtim analizoi në mënyrë kritike narrativat dhe strategjitë e inkuadrimit tashmë ekzistues të përdorura në këto diskurse, me qëllim të eksplorimit të ndikimit të dezinformatave dhe narrativave gjinore në opinionin publik dhe komunitetet e marginalizuara, veçanërisht tek atletet femra. Sa i përket rishikimit të literaturës, një fokus i veçantë iu kushtua hulumtimeve në lidhje me gratë dhe sportin, transfobisë në sport, veçanërisht në ngjarje globale si Olimpiada, fenomenit të dezinformatave gjinore, duke përfshirë format, kanalet dhe ndikimet e tyre, si dhe metodat për analizimin e diskursit në studimet e mediave. Përmes kësaj metodologjie gjithëpërfshirëse, hulumtimi synon jo vetëm të zbulojë narrativat gjinore dezinformuese, por edhe të bëjë rekomandime për trajtimin e këtyre diskurseve të dëmshme në të ardhmen.

Për qëllimet e kësaj analize, u bënë disa pyetje hulumtuese:

1. Cilat janë temat dominuese dhe narrativat mbizotëruese rreth grave në sport në media dhe rrjete sociale gjatë Lojërave Olimpikë?
2. Si përdoret dezinformimi gjinor për të formuar perceptimin e publikut për gratë në sport?
3. Cilat strategji gjuhësore dhe retorike përdoren për të përhapur transfobinë në këto kontekste?

Përmes analizës së raporteve gazetareske të publikuara në mediat online dhe komenteve në rrjetet sociale në lidhje me këto publikime - kjo analizë mbuloi përpunimin e një studimi të rastit, duke aplikuar analizën cilësore të përmbajtjeve të publikuara në periudhën ndërmjet 26 korrik dhe 27 gusht 2024. Mostra e hulumtimit përbëhet nga 400 raporte gazetareske në lidhje me Lojërat Olimpikë Verore të këtij viti dhe Imane Calif që publikohen në mediat online, si dhe 170

komente mbi postimet në raportet gazetareske në mediat sociale, më saktësisht në platformat Facebook, Instagram dhe YouTube.

Përmbajtjet me bazë gjinore u analizuan përmes disa aspekteve specifike: përdorimi i stereotipeve gjinore, prania e narrativave anti-gjinore dhe transfobike dhe rastet e gjuhës seksiste ose të urrejtjes. Për më tepër, hulumtimi u përqendrua në identifikimin e dezinformatave gjinore dhe përdorimin e gjuhës sensacionaliste në përmbajtje të tilla, si dhe përfshirjen e rishqyrtimit kritik të teksteve gazetareske dhe përdorimin e burimeve të ndryshme të informacionit.

# Studim i rastit:

## Narrativa me bazë gjinore gjatë Lojërave Olimpike në Paris

### Hapja e Lojërave Olimpike në Paris

Më 26 korrik 2024, Presidenti francez Emmanuel Macron hapi zyrtarisht Lojërat Olimpike Verore në Paris, duke shënuar 130 vjetorin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, njëqindvjetorin e Lojërave Olimpike Verore dhe Dimërore dhe 235 vjetorin e Revolucionit Francez. Siç përcaktohet nga Karta Olimpike, ceremonia e hapjes së Lojërave Olimpike përfshinte një program artistik që tregonte kulturën e vendit dhe qytetit pritës, paradën e atletëve dhe ndezjen e pishtarit olimpik.

Një nga shfaqjet në ceremoninë e hapjes u bë shpejt një objekt kritikash në të gjithë botën që u transmetua përmes mediave, përfshirë hapësirën mediatike maqedonase. Kritika, e cila erdhi kryesisht nga udhëheqësit e kishës dhe politikanët konservatorë, kishte të bënte me ngjashmërinë e një prej shfaqjeve me skenën biblike në pikturën e Leonardo da Vinçit “Darka e Fundit”, të cilën disa e quajtën një “përqeshje” të krishterimit.<sup>10</sup> Kështu, fokusi i kritikës përkatësisht përqeshjes ishte në faktin se performanca përfshinte drag queen, njerëz transgjinorë dhe figura të tjera publike që i përkisnin komunitetit LGBTI+. Organizatorët e ngjarjes mohuan lidhjen, si dhe qëllimin për përqeshjen e dikujt, duke shpjeguar se qëllimi i skenës është të promovojë diversitetin, si dhe të nderojë gastronominë franceze.

10 [An Olympics Scene Draws Scorn. Did It Really Parody ‘The Last Supper’? - The New York Times](#)

Më 27 korrik, disa media raportuan kritika nga përfaqësues dhe përfaqësuese të vendeve të ndryshme në lidhje me ceremoninë. Prandaj, dy raporte gazetareske përcjellin deklaratën e zëdhënëses së Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë, Maria Zakharova, sipas së cilës ceremonia ka elemente problematike dhe e cila dënoi parodinë LGBT të «Darkës së Fundit», me «apostuj të paraqitur si transvestitë».<sup>11</sup> Dy raporte të tjera përcjellin kritikën e kryeministrit hungarez Viktor Orban, i cili për hapjen e Lojërave Olimpikë thotë se nuk ka moral publik në Perëndim.<sup>12</sup> Disa ditë më vonë, gjashtë raporte gazetareske përcjellin një deklaratë të Presidentit turk Rexhep Taip Erdogan që e quan hapjen e Lojërave Olimpikë fyerje morale për të krishterët dhe për ne.<sup>13</sup> Ajo që kanë të përbashkët këto raporte gazetareske është se ato përcjellin deklarata nga burra shteti konservatorë që kanë pikëpamje anti gjinore dhe mbrojnë dhe zbatojnë politika të dëmshme për komunitetin LGBTI+.

Ndërkohë, publikohen disa kolumna të proto-presbiterit Ivica Todorov,<sup>14</sup> Biljana Vankovska,<sup>15</sup> Janko Ilkovski<sup>16</sup> dhe Strasho Angelovski,<sup>17</sup> si dhe qëndrimi i drejtorit të Kanal 5, Ivan Mirçevski,<sup>18</sup> në të cilat Lojërat Olimpikë quhen parodi, dekadencë dhe blasfemi. Një media publikon një kolumnë nga Irena Cvetkoviq në mbrojtje të diversitetit, duke i quajtur kritikën e ceremonisë si një manifestim të dukshëm të shqetësimit të përhapur shoqëror ndaj diversitetit gjinor.<sup>19</sup>

Më 28 korrik, nëntë raporte gazetareske përcollën faljen e organizatorëve të Lojërave Olimpikë duke thënë se kurrë nuk kanë pasur ndonjë qëllim për të treguar mosrespekt ndaj ndonjë grupi fetar, megjithatë edhe pse organizatorët mohuan çdo lidhje të performancës me «Darkën e Fundit», raportet vazhduan të përdorin simbolizmin, veçanërisht përmes titujve të tillë si **Organizatorët e LOV**

11 [Rusia: Ceremonia e hapjes së LOV ishte një dështim – Ekipi](#)

12 [Orban kundërshton politikën perëndimore në një fjalim dy-orësh- Radio Evropa e Lirë](#)

13 [Erdogan: Hapja solemne e LOV-së është fyerje morale për të krishterët dhe për ne - Info.mk](#)

14 [PROTOPREZVITER TODOROV: Qëndrimi im për hapjen e LO-së në Paris! – Denesen.mk](#)

15 [Hipokrizia dhe/ose dekadencia olimpikë? - Nova Makedonija](#)

16 [Olimpiada e parodizuar - Republika](#)

17 [KOLUMNA E ANGELOVSKI: Kalorësit e Apokalipsit në LO të Parisit – Denesen.mk](#)

18 [Blasfemi dhe dekadencë - Drejtori i Kanalit 5 kërkon disiplinën olimpikë: Kërcim në shkop dhe hedhje në distancë - Ekspres.mk](#)

19 [Burra me fustane, lojëra olimpikë dhe shpirtra të ofenduar - Prizma](#)

kërkuan falje për parodinë e «Darkës së Fundit»<sup>20</sup> dhe Organizatorët e Olimpiadës kërkuan falje për LGBT Darkën e Fundit, e<sup>21</sup> cila mund t'i shërbente publikut si konfirmim për dyshimet e mëparshme dhe një arsye e justifikueshme për revoltë. Për më tepër, vetëm katër raporte përcjellin shpjegimin e dhënë nga drejtori krijues i ceremonisë së hapjes, Thomas Jolie, për idenë se performanca simbolizon një festë pagane në lidhje me perënditë e lashta të Olimpikut dhe origjinën e Lojërave Olimpikë, nga të cilat vetëm një raport në titull “Darka e Fundit” Olimpikë është në të vërtetë një skenë nga një pikturë e perëndive greke që<sup>22</sup> informon për keqkuptimin e krijuar.

Më 29 korrik, filluan të publikohen raportet gazetareske në lidhje me dixhejen franceze Barbara Butch, me tituj si **(FOTO) REAGIMET NUK KANË TË NDALUR – Kjo është gruaja franceze që «luajti» Krishtin në hapjen e Olimpiadës: «Unë jam e shëndoshë, hebraike dhe lezbike queer»** e<sup>23</sup> cila ishte pjesë e performancës dhe u kritikua nga publiku se ka përfaqësuar ndërsa me këtë edhe ka tallur Krishtin. Më shumë se dhjetë raporte përcjellin informacione të ndryshme rreth Butch, duke e përshkruar atë si një aktiviste LGBTI+, ndërsa gjashtë nga raportet gazetareske raportojnë se pas performancës së saj në Lojërat Olimpikë ajo filloi të merrte kërcënime me vdekje, fyerje në lidhje me pamjen e saj, plot antisemitizëm, homofobi, seksizëm.<sup>24</sup>

## Vendimi i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar për pjesëmarrjen e dy boksierëve

Duke filluar nga 30 korrik, dhe në ditët në vijim, shfaqen tetë raporte gazetareske që përcjellin vendimin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (KON) për të lejuar boksieret Iman Khelif nga Algjeria dhe Lin Yu-tin<sup>25</sup> nga Tajvani të garojnë në

20 [Organizatorët e LOV kërkojnë falje për parodinë e Darkës së Fundit | Gol.mk](#)

21 [Organizatorët e Olimpiadës kërkojnë falje për darkën e fshehtë LGBT - SPORTM.mk](#)

22 [“Darka e Fundit” Olimpikë është në të vërtetë një skenë nga një pikturë e perëndive greke - Nezavisen Vesnik](#)

23 [\(FOTO\) REAGIMET NUK NDALEN- Kjo është gruaja franceze që “luajti” Krishtin në hapjen e Olimpiadës: “Unë jam e shëndoshë, hebraike dhe lezbike queer” » Ekran](#)

24 [“Po më kërcënojnë!” Vajza që mori pjesë në skenën problematike të hapjes së Olimpiadës vuan dhunë, dhe ngriti padi - Toçka](#)

25 [Përkundër faktit se teksti përdor mbiemrat e personave të përmendur tashmë, për boksieren Lin Yu-tin do të përdoret emri i saj – Yu-tin, për të qenë në përputhje me përdorimin në raporteve gazetareske dhe për të mos çuar në keqkuptime.](#)

Lojërat Olimpikë në Paris, të cilat më parë janë skualifikuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Boksit (ShNB) nga pjesëmarrja në disa kampionate botërore për mospërmbushjen e kriterëve për përkatësinë gjinore. Këtë vendim të KON-së raportet gazetareske e paraqesin duke përdorur tituj sensacionalë, si **Terror në Paris: Dy burra lejohen të “rrahin” gratë në LOV!**<sup>26</sup> dhe **Skandal Olimpik: Organizatori lejoi burra të boksojnë në turneun e boksit për femra!**<sup>27</sup> Kështu, raporte të ndryshme gazetareske mund të tregojnë përdorimin e informacioneve të ndryshme, madje edhe kontradiktore, në lidhje me gjininë e boksierëve, si dështuan në testin e gjinisë,<sup>28</sup> ndryshuan gjininë e tyre,<sup>29</sup> kanë kromozome XY,<sup>30</sup> kanë nivele të larta të hormoneve mashkullore.<sup>31</sup> Disa nga raportet gazetareske gjithashtu raportojnë se boksieret u përpoqën të mashtronin konkurrencën e tyre sepse pretendonin se ishin gra në mënyrë që të konkurronin në konkurrencën e tyre.<sup>32</sup> Për më tepër, gjysma e raporteve gazetareske që raportojnë këtë lajm vunë në dukje përdorimin e emrave dhe përemrave në gjininë mashkullore.

Dy boksierë të cilatve iu ndalua pjesëmarrja në kampionatet botërore sepse konsideroheshin biologjikisht meshkuj, u lejuan të garojnë në Olimpiadë si femra.<sup>33</sup>

Të nesërmen, vetëm katër raporte gazetareske përcjellin arsyetimin e KON për vendimin që të dy boksieret i plotësojnë kriteret për garim në Paris, megjithatë, deklarata e transmetuar është sipërfaqësore, përkatësisht përqendrohet në informacionin se në pasaportat e tyre shkruan se janë gra.<sup>34</sup> Vetëm një nga raportet citon një pjesë të deklaratës së KON që të gjithë atletët që marrin pjesë në turneun e boksit të Lojërave Olimpikë janë në përputhje me rregulloret e

26 [Horror në Paris: Dy burra lejohen të “rrahin” gratë në LOV! – Sport1.mk](#)

27 [Skandal Olimpik: Organizatori lejoi burra të boksojnë në turneun e boksit për femra! | Gol.mk](#)

28 [KON shpjegoi pranimin e sportistëve që kanë dështuar më parë në testin gjinor në konkursin për boks – IPON.mk](#)

29 [“RAHJA E GRAVE TANI ËSHTË NJË SPORT OLIMPIK”! Të lindur si burra, ndryshuan gjininë dhe tani boksojnë me gra – plusinfo.mk](#)

30 [Dy boksierë për të cilat ka dyshim se janë meshkuj u lejuan gjithashtu të garojnë në turneun e grave – Sport Mania](#)

31 [KON mbron boksieret e kontestuar të LOV: “Në pasaportat e tyre shkruan se janë gra” – Sport Mania](#)

32 [Skandal Olimpik: Organizatori lejoi burra të boksojnë në turneun e boksit për femra! | Gol.mk](#)

33 [Momenti kur trans boksierja Imane Kelif i jep goditje brutale kundërshtares së saj – pasi u lejua të luftonte në Olimpiadë si grua pavarësisht se u refuzua nga Kupa e Botës | Motika](#)

34 [KON mbron boksieret e kontestuar të LOV: “Në pasaportat e tyre shkruan se janë gra” – Sport Mania](#)



pranueshmërisë dhe hyrjes, si dhe të gjitha rregulloret mjekësore në fuqi në përputhje me rregullat 1.4 dhe 3.1 të Njesisë së Boksit Paris 2024.<sup>35</sup> Megjithatë, në gjysmën e këtyre raporteve, përsëri përdoren emrat dhe përemrat në gjininë mashkullore për boksieret.<sup>36</sup>

## Ndeshja e parë e boksit e Iman Kelifit

Ndeshja e parë e boksit e Iman Kelifit u zhvillua më 1 gusht, kur kundërshtarja e saj, italianian Angela Carini, ndërpreu garën pas vetëm 46 sekondash. Në të njëjtën kohë, narrativa që është në fokus të mediave është se Carini është tërhequr sepse ajo kurrë nuk ka marrë goditje kaq të forta në karrierën e saj, që në mediat paraqitet se Carini aludon për faktin se Kelifi është burrë. Ndeshja ngrit një sërë raportime gazetareske (më shumë se 40), dhjetëra prej të cilave kanë të njëjtat tituj, si **italiane në lot pasi luftoi me “burrë”**.<sup>37</sup> Pothuajse të gjitha raportet gazetareske kanë tituj sensacionalë në të cilët Kelifi portretizohet si burrë, siç është **Publiku ekspert është i neveritur: “Bota lejoi një burrë të rrahë një grua para të gjithëve ne...”**,<sup>38</sup> **Skandal: Boksierja e ndërpreu ndeshjen sepse luftoi kundër një burri biologjik**,<sup>39</sup> **Algjeriania ndryshoi gjininë godet si një burrë në ring**,<sup>40</sup> **Burri biologjik nga Algjeria shënoi fitoren e parëne LO**.<sup>41</sup>

Ajo që vërehet, si nga titujt ashtu edhe nga teksti në raportet gazetareske, është se mediat vazhdojnë të përdorin dezinformata të ndryshme në lidhje me gjininë e Kelifit, përkatësisht e prezantojnë atë kryesisht si një person mashkull ose transgjinator, ndërsa në disa raporte gazetareske përdoren përsëri emra të gjinisë mashkullore.<sup>42</sup>

35 [Dështuan në testet gjinore në Kupën e Botës, por do të garojnë në Olimpiadë | Off.net.mk](#)

36 [KON shpjegoi pranimin e sportistëve që kanë dështuar më parë në testin gjinor në konkursin për boks – IPON.mk](#)

37 [\(Video\) Italianja në lot pa ndeshjes me “burrë” – Makfax](#)

38 [Publiku ekspert është i tmerruar: “Bota ka lejuar një burrë të rrahë një grua para të gjithëve ne...” – Ekipi](#)

39 [Skandal: Boksierja ndërpret ndeshjen sepse po luftonte me një burrë biologjik – Sportski.mk](#)

40 [Ndryshoi gjininë Algjerianja godet si mashkull në ring - Republika](#)

41 [Burri biologjik nga Algjeria shënon fitoren e parë në Lojërat Olimpikë: Gruaja italiane dorëzoi ndeshjen pas 45 sekondash dhe shpërtheu në lot \(VIDEO\) – IPON.mk](#)

42 [Anxhela të largohet nga ringu dhe t'ia dorëzojë luftën rivalit të saj, për të cilin ajo këmbëngul se është burrë – Alon.mk](#)



Shumë kritika erdhën për shkak të vendimit për të lejuar një burrë të lindur i cili më vonë “u transformua” në një grua të boksojë në konkurrencë me femëra.<sup>43</sup>

Një raport gazetaresk me titull Çështjet gjinore në boks në LOV: Polemika mbi dy boksiere për shkak të njoftimit të një zyrtari rus në Telegram<sup>44</sup> publikon një analizë të shkurtër të rastit të dy boksiereve, duke dhënë këqyrje mbi rregullat e ndryshme kualifikuese dhe rrugën e dy boksiereve në Lojërat Olimpikë në Paris. Megjithatë, përpos asaj se bëhet fjalë vetëm për një çështje dyshimi, raporti e lidh drejtpërdrejt keqinformimin në lidhje me gjininë e Kelifit me një deklaratë të një zyrtari rus të botuar në Telegram vitin e kaluar duke pretenduar se të dy boksieret janë persona transgjinorë, por se nuk ka asnjë provë ose deklaratë publike për të treguar se të dy atletët identifikohen si transgjinorë dhe të dyja kanë konkurruar në konkurrencën e femrave gjatë gjithë karrierës së tyre.

Dy raporte gazetareske identike përcjellin deklaratën zyrtare të Komitetit Olimpik Bullgar, i cili pret që përgjegjësit e Lojërave Olimpikë të mos qëndrojnë indiferentë për pjesëmarrjen e dy boksiereve në Lojërat Olimpikë, ndërsa shkruajnë për Kelifin si boksieri/ja algjerian(e) që ra në testin për testosteron në vitin 2023.<sup>45</sup> Disa raporte gazetareske përcjellin gjithashtu deklaratën e kryeministres konservatore italiane Giorgia Meloni dhe shkrimtares britanike J.K. Rowling, meqë ra fjala, është e njohur për deklaratat e shpeshta transfobike në publik, të<sup>46</sup> cilat dënojnë pjesëmarrjen e Kelifit në kategorinë e grave. Një raport gazetaresk raporton deklaratën e dr. Robert Malone, një anti-vaksinues dhe i njohur për përhapjen e dezinformatave në lidhje me vaksinat Covid-19, i<sup>47</sup> cili thotë se Lojërat Olimpikë janë bërë turp me rregulla të çmendura dhe të

43 [Algjerianët qëndruan në mbrojtje të boksiereve që ka lindur si mashkull dhe presin që ajo të fitojë një medalje në LOV – Sport Mania](#)

44 [Çështjet gjinore në boks në LOV: Polemika mbi dy boksiere për shkak të njoftimit të një zyrtari rus në Telegram - Trn.mk](#)

45 [Komiteti Olimpik Bullgar inicion çështjen e barazisë gjinore në Olimpiadë - mia](#)

46 [Për shembull, J.K. Rowling deklaroi se Ligji për vepra penale nga urretja, i cili u miratua në Skoci, u jep më shumë rëndësi ndjenjave të burrave që shprehin idenë e tyre të feminitetit sesa të drejtave dhe lirive të grave dhe vajzave të vërteta. Shih më shumë në: J.K. Rowling: Ligji u jep më shumë rëndësi burrave që ndihen si gra, para të drejtave dhe lirive të grave të vërteta](#)

47 [Për shembull, dr. Robert Malone deklaroi se ka një rol kryesor në krijimin e vaksinave mRNA, por gjatë pandemisë ai u shfaq si një nga zërat më të diskutueshëm të lëvizjes kundër vaksinave, kundër njohurive kryesore rreth koronavirusit dhe shkencës shëndetësore. Shih më shumë në: As shkenca nuk ka konfirmuar efektet negative të vaksinave, as nuk ka pasur një Samit të Tretë Covid](#)

përziëra që nuk kanë kuptim. Rregullat që i përgjigjen tekave të meshkujve biologjikë, në krahasim me sigurinë e kundërshtarëve të tjerë.<sup>48</sup>

Katër raporte gazetareske identike përcjellin deklaratën e klubit serb Ushçe, në të cilën dërgojnë mbështetje për Carinin, duke deklaruar se ajo është një kampione e vërtetë, për të cilën klubi i dërgon asaj një medalje të artë.<sup>49</sup>

Të nesërmen, më 2 gusht, u publikuan raportet gazetareske për tema të ndryshme në lidhje me Kelifin. Kështu, në dhjetëra raporte, si **Kelif, megjithatë është femër-Karini i kërkoi falje: Nëse e takoj, do ta përqafoj!**,<sup>50</sup> përcillet falja e Karinit për Kelifin, duke marrë parasysh sulmet ndaj Kelifit që ishin rezultat i reagimit të saj gjatë ndeshjes. Tre raporte përcjellin njoftimin e Komitetit Olimpik Algjerian në mbrojtje të Kelifit dhe dënimin e shënjestrimit jo etik dhe ndotjes së reputacionit të atletes sonë të shquar.<sup>51</sup> Megjithatë, shumica e raporteve gazetareske (më shumë se dhjetë), me tituj të tillë si **Iman Kelif megjithatë është vetëm një grua e fortë**<sup>52</sup> dhe **E vërteta për Iman Kelif: Ajo është më e fortë se gratë «e zakonshme», por ajo megjithatë është... një grua!**<sup>53</sup> ndajnë fotografi të Kelifit si fëmijë në të cilat për shumicën e njerëzve bëhet «e qartë» se Kelifi ka lindur dhe është rritur si vajzë. Përveç kësaj, ndahen informacione se operacionet e ndryshimit të seksit janë të ndaluara në Algjeri. Nga raportet gazetareske të publikuara, veçanërisht nga titujt, mund të vërehet se, përveç sensacionalizmit, gazetarët/et fillojnë të reterojnë nga dënimi i tyre ndaj Kelifit, i cili ishte i pranishëm përmes sensacionalizmit dhe gjuhës së pandjeshme gjinore të përdorur në raportet gazetareske në periudhën e kaluar.

Vetëm dy raporte gazetareske përcjellin njoftimin e KON në lidhje me boksieret që kanë qenë subjekt i sulmeve, për të cilat thuhet se kanë qenë viktimat e një

48 [DR. MALONE PËR RRAHJEN E NJË BOKSIERE FEMËR NGA NJË BOKSIER MASHKULL: Realiteti i çmendur dhe i ashpër i Lojërave Olimpikë të Parisit sapo është bërë më i çmendur dhe më vdekjeprurës – Denesen.mk](#)

49 [Gruaja italiane për të cilën po flasin të gjithë do të marrë një medalje të artë nga një klub serb - Makfax](#)

50 [Kelif, megjithatë është vajzë – Karini i kërkoi falje: Nëse e takoj, do ta përqafoj! | Gol.mk](#)

51 [Algjerianët në mbrojtje të Helifit: Sulmet ndaj boksieres janë të pabaza – Kurir](#)

52 [Imane Kelif megjithatë është vetëm një grua e fortë - Libertas](#)

53 [E vërteta për Imane Kelif: Ajo është më e fortë se gratë “e zakonshme”, por ajo megjithatë është...grua! - Llokalno](#)

vendimi të papritur dhe arbitrarisht të ShNB. Në fund të Kupës së Botës 2023, ato papritmas u skualifikuan pa një proces përkatës.<sup>54</sup>

Në media u hap debat në lidhje me kriteret e kualifikimit në konkurrencën e grave, si dhe mënyrat në të cilat gjinia përcaktohet nga organizata të ndryshme sportive. Kështu, një media publikon një raport gazetaresk me një analizë të shkurtër të kriterëve për pjesëmarrje në garat e LOV përkundër atyre të ShNB, ku thuhet se atletët nuk iu nënshtruan testit për testosteron, por iu nënshtruan një testi të veçantë dhe të pranuar,<sup>55</sup> duke cituar referenca nga një analizë e New York Times, njoftimet zyrtare të LOV dhe ShNB, si dhe burime dhe komente të tjera. Një media tjetër bën një analizë kronologjike të ngjarjeve, përfshirë deklaratat nga KON, por edhe komentet nga Meloni.<sup>56</sup> Dy raporte gazetareske përmendin takimin e Kryetarit të KON Thomas Bach me Meloni, në lidhje me ndeshjen e boksit midis Carini dhe Kelif, pas së cilës Bach deklaroi se ishte dakord me nevojën për të përmirësuar metodat shkencore në drejtim të vlerësimit të gjendjes së atletëve me karakteristika të tilla si nivelet e larta të testosteronit tek gratë.<sup>57</sup>

E njëjta media publikon dy raporte në të cilat raporton deklaratat nga promovuesi i boksit Eddie Hearn<sup>58</sup> dhe boksieri Jake Paul,<sup>59</sup> i cili e quan pjesëmarrjen e Kelifit një parodi të shpifur.

